Muhammedi, alejhis-selam, është Pejgamberi ynë.

Allahu e dërgoi atë tek të gjithë njerëzit.

Muhammedi, alejhis-selam, ishte një njeri që jetonte para shumë kohësh.

Allahu ia zbriti atij Kuranin.

E di ti, se ç'është Kurani?

Kurani është Libri i Allahut.

Njerëzit e mirë e lexojnë Kuranin në çdo kohë.

Njerëzit e mirë e duan Kuranin dhe e dëgjojnë atë.

Kurani është shumë i bukur.

Muhammedi, alejhis-selam, e donte Kuranin, ai e do Librin e Allahut.

Muhammedi, alejhis-selam, e lexonte shumë Kuranin.

Muhammedi, alejhis-selam, ua mësonte njerëzve Kuranin.

Ai, alejhis-selam, ishte njeriu më i mirë.

Njerëzit e mirë mundohen të bëhen, tamam, si Muhammedi, sal-lallahu alejhi ve sel-lem.

Në qoftë se dikush të pyet:

"Cili është Pejgamberi yt?"

Ti thuaj atij:

"Pejgamberi im është Muhammedi, sal-lallahu alejhi ve sel-lem."

Pyetje:

Kush është Muhammedi?

Burimi: Al-tamhid.net

Nga gjermanishtja: Jusuf Kastrati

Phoca PDF